


[Shpalljet ▼](#)
[Kthehu](#)


[NR
SHPALLJES]

INSTITUTI I STATISTIKAVE

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Lloji i diplomës "Shkenca Ekonomike / Shkenca Natyrore / Shkenca Sociale". Niveli minimal i diplomës "Master profesional"

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Instituti i Statistikave shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

1. Specialist - Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit të Mbledhjes së të Dhenave, Drejtoria e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhenave, Instituti Statistikave - Kategoria: III-b

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme

PËR TË DY PROCEDURAT PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

(LEVIZJE PARALELE, PRANIMI NE SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

23/10/2021

LËVIZJE PARALELE

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

28/10/2021

PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:

Specialisti i sektorit të Planifikimit dhe Mmonitorimit të Mbledhjes së të Dhënave përgjigjet tek përgjegjësi i sektorit për realizimin e aktiviteteve në përputhje me objektivat e sektorit në kuadër të planit të statistikave zyrtare. Siguron planifikimin dhe funksionimin e procesit të mbledhjes së të dhënave nëpërmjet përdorimit të procedurave dhe instrumenteve të mbledhjes së të dhënave, me njohuri në anketa statistikore, mbledhje dhe/ose monitorim të dhënash në terren. Menaxhon komponentët organizative, administrative dhe monitoron procesin në bazë të përmbajtjes së informacionit të kërkuar dhe kohës në dispozicion referuar prodhimit statistikor duke kryer dhe verifikim në terren pranë Zyrave Rajonale Statistikore.

1 LEVIZJE PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a - Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori ekzekutive;
- b - Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c - Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Profesional" në Shkenca Ekonomike, / Shkenca Sociale / Shkenca Natyrore.
- b - Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të ietë në të njëjtën fushë.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

http://instat.gov.al/media/6078/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx

(http://instat.gov.al/media/6078/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx)

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore (kliko këtu (http://www.instat.gov.al/media/6400/formular_vetdeklarimi.pdf) për ta shkarkuar);

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër:

1 - Do të bëhen online, në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Institutit të Statistikave, duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijmësi udhëzimet online

<http://rekrutime.instat.gov.al/help.pdf>

2 - Në përfundim të aplikimit online, dokumentat e përmendura më sipër, së bashku me një kërkesë ku ju specifikoni pozicionin ku dëshironi të konkuroni, duhet të dorëzohen pranë INSTAT

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: 23/10/2021

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **25/10/2021**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Institutit të Statistikave, do të shpallë në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Institutit të Statistikave, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Institutit të Statistikave, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET

INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

1. Njohuri mbi Ligjin Nr.17/2018 "Për statistikën zyrtare".
2. Njohuri mbi Ligjin nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"
3. Njohuri mbi Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2017-2021: <http://www.instat.gov.al/media/3594/psz-2017-2021.pdf>
4. Njohuri mbi "Principles and Recommendations for Population and Housing Censuses Rev3: https://unstats.un.org/unsd/publication/seriesM/Series_M67Rev3en.pdf
5. Njohuri mbi "Handbook on Geospatial Infrastructure in support of Census Activities": https://unstats.un.org/unsd/demographic/standmeth/handbooks/series_f103en.pdf

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al" <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015> (<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>)

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Institutit të Statistikave, do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Institutit të Statistikave, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione

vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen elektronike të Institutit të Statistikave, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut, duke filluar nga data 28/10/2021

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Profesional" në Shkenca Ekonomike, / Shkenca Sociale / Shkenca Natyrore.
- b - Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
http://instat.gov.al/media/6078/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx
(http://instat.gov.al/media/6078/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx)
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore (kliko këtu
(http://www.instat.gov.al/media/6400/formular_vetdeklarimi.pdf) për ta shkarkuar);
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen online, në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Institutit të Statistikave, duke filluar me

procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijmësi udhëzimet online
<http://rekrutime.instat.gov.al/help.pdf>

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online për procedurën e pranimi në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 28/10/2021

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **7/11/2021**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Institutit të Statistikave, do të shpallë në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Institutit të Statistikave, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimi në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimi në kategorinë ekzekutive dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Institutit të Statistikave, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

1. Njohuri mbi Ligjin Nr.17/2018 "Për statistikën zyrtare".
2. Njohuri mbi Ligjin nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"
3. Njohuri mbi Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2017-2021:
<http://www.instat.gov.al/media/3594/psz-2017-2021.pdf>
4. Njohuri mbi "Principles and Recommendations for Population and Housing Censuses Rev3: https://unstats.un.org/unsd/publication/seriesM/Series_M67Rev3en.pdf
5. Njohuri mbi "Handbook on Geospatial Infrastructure in support of Census Activities":
https://unstats.un.org/unsd/demographic/standmeth/handbooks/series_f103en.pdf

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015> (<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>)

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Institutit të Statistikave, do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Institutit të Statistikave, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në Shërbim Civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen elektronike të Institutit të Statistikave, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data 7/11/2021.

Copyright © 2021 Instituti i Statistikave